



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:019613

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06782205

P.nr.40/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtore profesionale Leonita Lajçi-Mucaj, në çështjen penale kundër të pandehurve S.B dhe L.B, për veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*”, të kryer ne bashkëkryerje nga neni 185, par.1, nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë– Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë PP.II.nr.2427/2023 të datës 15.01.2024, pas referimit të çështjes në procedurën e ndërmjetësimit, si dhe pas pranimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit të dt.29.01.2026, në kuptim të nenit 229 par.5 e lidhur me nenin 357 par. 1 nën par. 1.3 dhe par. 2 të KPPRK-së, jashtë seancës, me datën 30.01.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET**– marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me nr. të referencës të ndërmjetësimit ND.nr.51/25 e dt.29.01.2025, në mes të pandehurve S.B dhe L.B dhe të dëmtuarës H.Vj ashtu që:
- II. HUDHET**, aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2427/2023 të datës 15.01.2024, kundër të pandehurve S.B dhe L.B, për veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*”, për shkak të arritjes së marrëveshjes së ndërmjetësimit.
- III. PUSHOHET**, procedura penale, kundër të pandehurve kundër të pandehurve S.B dhe L.B, për veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*”, për shkak të arritjes së marrëveshjes së ndërmjetësimit.
- IV.** Marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- V. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.**

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me datën 15.01.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP.II.nr.2427/2023 kundër të pandehurve S.B dhe L.B, për veprës penale “Lëndim i lehtë trupor”, të kryer ne bashkëkryerje nga neni 185, par.1, nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me datë 01.10.2024, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtarja pasi që u bind se te akuzuarit e kanë kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 dhe përkundër paralajmërimit për nenet 325 dhe 323 të KPPK-së, të pandehurve ju ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohen të pa pafajshëm. Të pandehurit janë deklaruar të pa fajshëm lidhur me veprën penale e cila ju vihet ne barë konkretisht për veprës penale “Lëndim i lehtë trupor”, të kryer ne bashkëkryerje nga neni 185, par.1, nën par.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Meqenëse të pandehurit nuk janë deklaruar fajtor për veprën penale si në aktakuzë, në bazë të nenit 240 par.7 të KPPRK-së, Gjyqtarja e vetme gjykuese e njofton të pandehurit dhe mbrojtësin se jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar, mund të paraqesin propozimet për kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të këtij Kodi; dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës në pajtim me nenin 244 paragrafit 1 të këtij Kodi.

Mirëpo, meqenëse mbrojtësi i të pandehurit S.B deklaroi se heqin dore nga kundërshtimi i provave duke propozuar që të caktohet seanca e shqyrtimit kryesor gjyqësor, te cilin propozim nuk e kundërshtuan as palët e tjera ne procedura, gjykata me datën 29.01.2025, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën e dëmtuara H.V i propozoj gjykatës qe kjo lëndë të shkoj në procedurën e ndërmjetësimit.

Këtë propozim të dëmtuarës e ka mbështetur edhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av.Shpëtim Berisha, i pandehuri S.B, mbrojtësi i të pandehurit, av.Agim Haxhija si dhe e pandehura L.B. Po ashtu, lidhur me këtë propozim, edhe prokurori i shtetit Ermal Demhasaj ka deklaruar se: *pajtohem me propozimin e të dëmtuarës, jap miratimin qe kjo çështje penale të shkoj në procedurë të ndërmjetësimit pasi qe i plotëson kushtet, pasi qe palët nuk kanë marrëdhënie familjare midis tyre.*

Gjykata me datën 29.01.2025, e ka referuar këtë lëndë në procedurë të ndërmjetësimit, në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësim i cili në nenin 8, par.1, parasheh se: “Procedura e ndërmjetësimit mund të iniciohet nga palët, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ sipas legjislacionit në fuqi”, ndërsa në par.2, po të këtij neni parasheh, “nëse rasti gjendet në gjykatë, prokurori apo në organin kompetent administrativ dhe palët pajtohen për të shkuar në ndërmjetësim, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ informon dhe udhëzon palët në procedurën e ndërmjetësimit”.

Po ashtu sipas nenit 229 par.1, të KPPRK-së, parasheh se: “Para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet apo me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim.

Pas ngritjes së aktakuzës, me miratim të prokurorit, i dëmtuari dhe i pandehuri apo gjyqtari i vetëm gjykues mund ta referoj çështjen, për këto vepra në ndërmjetësim. Para se ta bëjë këtë, prokurori i shtetit apo gjyqtari i vetëm gjykues merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij dhe nëse ndërmjetësimi është në interes të të dëmtuarit ose viktimës”.

Ndërkaq, gjykata me datën 29.01.2025, ka pranuar marrëveshjen nga Qendra e Ndërmjetësimit në Pejë, me numër të referencës të ndërmjetësimit ND.nr.51/25, përmes të cilit është njoftuar se në mes të pandehurve S.B dhe L.B dhe të dëmtuarës H.V, është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit e ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesja Kaltrina Rexhepi Imami.

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit palët kanë deklaruar marrëveshjen se: Palët në seancën e ndërmjetësimit të mbajtur 29.01.2025 u pajtuan si me poshtë: -Palët "B" këtu L.B dhe S.B, deklarojnë njëzëri se i kërkojnë falje palës A këtu H.V për rastin që ka ndodhur, duke shtuar se rastet e tilla nuk do të përsëriten me. Pala "A" H.V deklaroi se e pranon kërkimin faljen nga ana e palëve "B" këtu L.B dhe S.B, duke shtuar se çdo gjë do të jetë në rregull në mes neve, mirëpo duke deklaruar se kërkon kompensim në lidhje me shpenzimet e mjekimit të cilat janë në shumën prej 200 (dyqind)euro. -Palët B deklarojnë njëzëri se pranojnë që të bëjnë kompensimin në lidhje me shpenzimet e mjekimit në shumën prej 200 (dyqind)euro për palën "A" H.V, edhe atë menjëherë në këtë seancë të ndërmjetësimit, duke i dorëzuar personalisht palës "A" H.V. Pala "A" deklaroi se në një situatë të tillë si palë e dëmtuar në këtë rast pasi që ishte arritur marrëveshja e ndërmjetësimit deklaroi se nuk ka interes juridik që të vazhdohet ndjekja penale ndaj palëve "B" dhe duke shtuar se nuk ka kërkesa për kompensim. Palët B deklarojnë se pajtohen me deklarin e palës "A".

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e pasi që në rastin konkret Prokurorja e Shtetit ka dhënë miratimin, dhe pasi që mes të pandehurve S.B dhe L.B dhe të dëmtuarës H.V është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit me datë 29.01.2025, gjykata ka analizuar marrëveshjen në fjalë dhe ka gjetur se palët kanë lidhur marrëveshjen e ndërmjetësimit me vullnet të lirë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-009 Për Ndërmjetësim, përkatësisht nenet 12 dhe 15 paragrafi 1, andaj të njëjtën e aprovoi si dhe ta hedhë aktakuzën e prokurorisë dhe rrjedhimisht ta pushojë procedurën penale ndaj të pandehurve S.B dhe L.B, në kuptim të nenit 229 par. 5 të KPPRK-së¹, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit, përkatësisht hodhi aktakuzën dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurve, duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 5 dhe nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së.

¹ Me marrjen e njoftimit për arritjen e marrëveshjes, prokurori i shtetit e hedh kallëzimin penal ose e ndërprente procedurën penale. Nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprente procedurën penale.

Vendimi si në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktvendimi, se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve në këtë çështje penale, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi, u mor konform nenit 229 par.6 të KPPRK-së.

Vendimi si në pikën V, të dispozitivit të këtij aktvendimi, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale u mor konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Prandaj, nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 229 par. 5 e lidhur me nenin 357 par. 1 nën par.1.3 dhe par. 2 dhe nenit 453 të KPPRK-së, dhe nenin 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësimin, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL
P.nr.40/24, me datë 30.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese,

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej tri (3) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.